

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Administrimit Publik, si dhe me specialisten e Marrëdhënieve me Publikun zhvilluan një trajnim dy ditor me temë "Menaxhimi i rrjeteve sociale".

Trajnimi kishte si qëllim t'ju ofronte studentëve njohuri të thelluara mbi përdorimin e rrjeteve sociale dhe rëndësinë e tyre për bizneset dhe organizatat moderne. Ky trajnim u fokusua në strategjitë e marketingut në rrjete sociale, analizën e performancës, sigurinë, privatësinë dhe etikën në rrjete sociale. Trajnimi synon të përgatisë studentët për t'u angazhuar në menaxhimin profesional të rrjeteve sociale dhe të kontribuojë në përgatitjen e tyre për tregun e punës.

Në këtë trajnim u trajtuan temat:

- Kuptimi dhe rëndësia e rrjeteve sociale
- Analiza e rrjeteve sociale
- Strategjitë e menaxhimit të rrjeteve sociale
- Strategjitë e marketingut në rrjete sociale
- Menaxhimi i krizave dhe përgjigje ndaj komenteve negative
- Siguria dhe privatësia në rrjete sociale



